

**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
MIA MASSAGES & SPA 2024 SHPK**

1. Sot me date 16.08.2024 **Z. Ilir ALLMUÇA** shtetas Shqipëtare, i biri Refik, lindur me 18.05.1966, në Tiranë dhe banues Tiranë, Albania, madhor me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, identifikuar nëpërmjet Pasaportes së identitetit ID me Nr.**BB4606138** dhe nr **Sig G605181550**.

Të cilët hartojnë këtë Akt Themelimi të shoqërisë **MIA MASSAGES & SPA 2024 SHPK** mbeshtetur në ligjin 9901 datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, ligjin 9723 datë 03.05.2007 "Për Qendren Kombetare të Rëgjistrimit", Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, si më poshtë:

KREU 1

Neni 1

Krijimi

Shoqëria **MIA MASSAGES & SPA SHPK**, është person juridik i të drejtës shqipëtare, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (me poshtë e quajtur "Shoqëria").

Neni 2

Personaliteti juridik

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendren Kombetare të Biznesit (QKB), në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Shoqëria **MIA MASSAGES & SPA 2024 SHPK** është një shoqëri, që themelohet ndërmjet ortakëve që përballojnë humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin themeltar.

Neni 3

Selia

Shoqëria e ka selinë në Rruga e Durrësit, God Nr. 85, H Nr.1, Ap Nr.4 ZK Nr.8210 Nr Pas 4/7+1-4 Tiranë,

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e sajë, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Ortakëve të Shoqërisë.

Neni 4

Objekti i veprimtarisë

Objekti i veprimtarisë së kësaj shoqërie është:aktivitet tregtar në fushen **Qender Estetike, Parukeri, Massage & Spa etj..**

Neni 5

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë **MIA MASSAGES & SPA 2024 SHPK** është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

KREU II **KAPITALI**

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100,000 lekë (njëqindmijë leke).

- a) Ortaku Z. **Ilir ALLMUÇA** është zotëruese i një kuote me vlere nominale 100,000 leke, që përben 100 % te kapitalit themeltar.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtë parashkruhet brenda 3 vjetëve nga çasti i cenimit.

Neni 7

Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

1. a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
b) Shitblerjes;
c) Trashëgimisë;
ç) Dhurimit;
d) Çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.
2. Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.
3. Statuti mund të kushtëzojë kalimine kuotave, veçanërisht duke përcaktuar miratimin e shoqërisë ose të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakëve të tjerë.
4. Në rastet e kalimit të kuotave me kontratë, kushtet dhe momenti i kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotën, si dhe kushtet e tjera të kalimit, përfshirë momentin e pagesës së çmimit, rregullohen nga kontrata. Kontrata për kalimin e kuotës hartohet në formë shkresore dhe noterizimi nuk përben kusht për vlefshmërinë apo regjistrimin e kontratës. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet shprehimisht ndryshe nga ligji apo kur palët bien dakord në kontratë, vlefshmëria e kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotat nuk do të kushtëzohet nga kryerja e formaliteteve të ndryshme me efekt deklarativ, përfshi këtu formalitetet e regjistrimit ose të publikimit të kontratës apo të kalimit të titullit.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarrës

Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;

- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) Kreditimin në çfaredo banke apo institucion financiar kreditor.
- j) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9

Administrimi

Shoqëria do të administrohet nga Z. **IIR ALLMUÇA** sipas statutit dhe ligjit për një **periudhe 5 vjeçare me të drejte ripërritje**.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti, apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë.

Përveç kësaj, administratorët shkarkohen nga gjykata për shkelje të ligjit me kërkesë të çdonjërit prej ortakëve.

Tagrat e përfaqësimit të administratorëve dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Administrator i shoqërisë mund të emerohet edhe një person jashtë ortakërisë.

Neni 10

Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatitë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratori ka të drejte të kryeje të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve, bankat e te gjitha niveleve etj. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, si perpara Bankave te te gjitha nivele, per te kryer derdhje, terheqje, transfertat, etj, perpara Zyrave te Tatim Taksave, Zyrave te Qeverisjes Vendore, Zyrave te Punes, Autoriteteve Doganore, etj, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve te shoqerise. Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Neni 11

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qëndren Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 12

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjisllacionit shqipëtar.

Për sa nuk parashikohet në statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 13

Mosmarrëveshjet

Peër mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e statutit, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqipëtare.

Neni 14

Dispozita perfundimtare

Ky statut u redaktua në 4 ekzemplare me permbajtje dhe vlera të njëjta juridike, në gjuhen shqipe, u miratua në parim nen për nen nga Ortaku i shoqërisë tregtare **MIA MESSAGES & SPA 2024 SHPK** nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen orgjinale.

ORTAKU THEMELUES I SHOQËRISË MIA MESSAGES & SPA 2024 SHPK

Ilir ALLMUÇA